



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/03

Datë: 06.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 qershor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Shfuqizohen Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, si në vijim:
  - 1.1. Vendimi i Qeverisë Nr. 01/14, i datës 20 mars 2020;
  - 1.2. Vendimi i Qeverisë Nr. 01/20, i datës 31 mars 2020, për zbatimin gradual të reciprocitetit si parim në marrëdhëniet me Serbinë;
  - 1.3. Vendimi i Qeverisë Nr. 01/37, i datës 30 maj 2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/20, të datës 31 mars 2020, për zbatimin gradual të reciprocitetit si parim në marrëdhëniet me Serbinë.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë